



UNHCR
The UN Refugee Agency
European Commission

**Procedurat e regjistrimit të
Gjendjes Civile dhe Kërkesat e
aplikimit për dokumente
personale.
Rëndësia e të drejtës për
ankesë**

*Projekt i implementuar nga partneri
implementues i UNHCR-së "Programi për të
Drejtat Civile Kosovë" (CRP/K)*



CRP/K
PROGRAMI PËR TË DREJTAT CIVILE KOSOVË
CIVIL RIGHTS PROGRAM KOSOVO
PROGRAM GRADANSKIH PRAVA KOSOVA

I. REGJISTRIMI I GJENDJES CIVILE

1. Ç'ËSHTE REGJISTRIMI I GJENDJES CIVILE?

Regjistrimi i gjendjes civile është evidentimi i fakteve të jetës - **lindja, martesat, vdekja**, në Regjistrat e Gjendjes Civile.

2. Ç'ËSHTE REGJISTRIMI I GJENDJES CIVILE?

Të gjitha lindjet, martesat dhe vdekjet evidentohen në Regjistrat e Gjendjes Civile, që mbahen nga Zyra Komunale e Gjendjes Civile në secilën Komunë.

3. PSE ËSHTE REGJISTRIMI CIVIL I RËNDËSISHËM PËR MUA DHE FAMILJEN TIME?

Regjistrimi i gjendjes civile ka shumë dobi për individin, por edhe për shoqërinë në tërësi. Është me rëndësi që lindjet, martesat dhe vdekjet t'i raportohen Zyrës përkatëse Komunale të Gjendjes Civile. Regjistrimi i Gjendjes Civile:

- Krijon identitetin tuaj ligjor si individ dhe si anëtar i një shoqërie të organizuar;
- Lehtëson qasjen tuaj në të drejtat tjera civile dhe sociale, siç është e drejta për kujdes shëndetësor, punësim, shkollim, për mirëqenie sociale, për pension, votë, etj.;
- I kontribuon një mjedisi më të sigurt;
- Është burimi i informacioneve statistikore për popullsinë dhe për trendet sociale/kulturore

4. SI MUND T'I REGJISTROJ FAKTET E JETËS NË REGJISTRAT E GJENDJES CIVILE?

Ju mund t'i drejtoheni Zyrës së Gjendjes Civile të Komunës suaj të lindjes ose të banimit dhe të kërkonit informata për atë se çfarë nevojitet për regjistrimin e gjendjes civile.

Zyrtarët do t'ju informojnë lidhur me të drejtat tuaja dhe ata do t'ju udhëzojnë se si mund të pajiseni me dokumentacionin e nevojshëm. Nëse ju nuk posedoni asnjë lloj dokumenti, zyrtarët komunalë do t'ju informojnë për mundësitë tjera.

5. CILAT JANË KËRKESAT PËR REGJISTRIMIN E GJENDJES CIVILE?

A. LINDJA

CILA ËSHTË PROCEDURA E REGJISTRIMIT TË LINDJES ?

- a. Nëse lindja ndodh në spital/institucion shëndetësor, nga Zyra Komunale e Gjendjes Civile e komunës së lindjes kërkohen këto dokumente:
 - Aplikacioni për regjistrimin e faktit të lindjes, i dorëzuar nga njëri prind;
 - Fletë-lëshimi i spitalit;
 - Kopja e vërtetuar e certifikatës së martesës së prindërve, nëse ata janë të kurorëzuar. Nëse prindërit nuk janë të kurorëzuar, mjafton pranimi i amësisë (ose i atësisë, kur nëna për shkaqe objektive nuk mund të dëshmojë), nëpërmjet një deklarate pranë Zyrës Komunale të Gjendjes Civile;
 - Kopjet e dokumenteve të identifikimit të prindërve të fëmijës, nëse ekzistojnë.

- b. Nëse lindja ndodh në shtëpi ose kudo jashtë një institucioni shëndetësor, nga Zyra Komunale e Gjendjes Civile e komunës së lindjes kërkohen këto dokumente:
 - Aplikacioni i dorëzuar nga njëri prind
 - Certifikata e vaksinimit të fëmijës
 - Deklarata e dëshmitarit se fëmija ka lindur jashtë institucionit shëndetësor (zakonisht jepet nga personat që kanë ofruar ndihmë gjatë lindjes)
 - Kopja e vërtetuar e certifikatës së martesës së prindërve, nëse ata janë të kurorëzuar. Nëse prindërit nuk janë të kurorëzuar, mjafton pranimi i amësisë (ose i atësisë në rastet kur e ëma nuk mund të dëshmojë për shkaqe objektive), nëpërmjet një deklarate pranë Zyrës Komunale të Gjendjes Civile;

- Kopjet e dokumenteve të identifikimit të prindërve të fëmijës, nëse ekzistojnë.
- c. Nëse lindja ndodh jashtë vendit, nga Zyra e Gjendjes Civile e komunës së banimit të fundit të njërit prind, kërkohen këto dokumente:
- Kërkesa për regjistrim e faktit të lindjes të parashtruar nga njëri prej prindërve;
 - Kopja e vërtetuar e certifikatës së lindjes, e lëshuar nga shteti ku ka ndodhur lindja;
 - Kopja e vërtetuar e certifikatës së martesës së prindërve, nëse ata janë të kurorëzuar. Nëse prindërit nuk janë të kurorëzuar, mjafton pranimi i amësisë (ose i atësisë në rastet kur e ëma nuk mund të dëshmojë për shkaqe objektive), nëpërmjet një deklarate pranë Zyrës Komunale të Gjendjes Civile;
 - Kopjet e dokumenteve të identifikimit të prindërve ose ndonjë dëshmi tjetër e lidhjes së tyre me Kosovën.

Mbani mend:

1. Kur prindërit e fëmijës nuk janë të kurorëzuar, lindja mund të regjistrohet pas pranimit të amësisë (ose të atësisë).
2. Po ashtu, nëse të dy prindërit janë të panjohur, ose fëmija është i gjetur, procedura e regjistrimit të lindjes inicohet nga Qendra Komunale për Punës Sociale. Lindja mund të raportohet nga anëtarët e familjes së ngushtë ose nga personat që e kanë gjetur fëmijën.

B. MARTESA

CILA ËSHTË PROCEDURA E REGJISTRIMIT TË MARTESËS?

- a. Nëse martesa kryhet në territorin e Kosovës dhe asnjëri prej bashkëshortëve nuk është shtetas i huaj, Zyrës Komunale të Gjendjes Civile të Komunës së banimit i prezantohen dokumentet në vijim:

- Kërkesa për regjistrim e faktit të lindjes të parashtruar nga njëri prej prindërve;
 - Kopjet e vërtetuara të certifikatave të lindjes për të dy bashkëshortët;
 - Certifikata e statusit martesor për të dy bashkëshortët
 - Kopjet e dokumenteve të identifikimit për të dy bashkëshortët, nëse ekzistojnë.
- b. Për ta regjistruar martesën, kur njëra palë ka shtetësi të huaj ose banim në shtetet e huaja, Zyrës Komunale të Gjendjes Civile të Komunës së banimit të njërit prej bashkëshortëve, kur regjistrimi bëhet në Kosovë, i duhet prezantuar dokumentet në vijim:
- Aplikacioni i dorëzuar nga njëri prej bashkëshortëve;
 - Kopjet e vërtetuara të certifikatës së lindjes për të dy bashkëshortët;
 - Certifikata e kapacitetit martesor për bashkëshortin që banon jashtë vendit ose ka shtetësi të huaj;
 - Certifikata e statusit martesor për të dy bashkëshortët;
 - Certifika e banimit për bashkëshortin që banon jashtë vendit ose ka shtetësi të huaj, nëse të dhënat e banimit nuk janë përfshirë në certifikatën e kapacitetit martesor;
 - Kopjet e dokumenteve të identifikimit për të dy bashkëshortët, nëse ekzistojnë.

Mbani mend: Nëse statusi martesor i njërit prej bashkëshortëve është i "shkurorëzuar", duhet të prezantohet vendimi i gjykatës për shkurorëzim.

C. VDEKJA

CILA ËSHTË PROCEDURA E REGJISTRIMIT TË VDEKJES?

- a. Fakti i vdekjes mund të regjistrohet në Zyrën Komunale të Gjendjes Civile

të Komunës ku ka ndodhur vdekja, nga një anëtar i familjes së ngushtë. Nëse vdekja ka ndodhur në një institucion shëndetësor ose në praninë e mjekut, duhet prezantuar dokumentet në vijim:

- Aplikacioni për regjistrimin e vdekjes;
- Kopja e dokumentit të identifikimit, për personin që e raporton vdekjen;
- Certifikata mjekësore për faktin dhe shkakun e vdekjes; (Institucioni mjekësor, sipas detyrës zyrtare do ta njoftojë edhe Komunën)
- Kopja e certifikatës së martesës, nëse i ndjeri / e ndjera ka qenë i/e kurorëzuar. Nëse i ndjeri / e ndjera nuk ka qenë i/e kurorëzuar, ose ka qenë i/e pamartuar, ose ka qenë i/e shkurorëzuar, Zyra Komunale e Gjendjes Civile do ta bëjë këtë shënim në regjistra.

b. Nëse vdekja nuk ka ndodhur në ndonjë institucion shëndetësor ose në praninë e mjekut, duhet prezantuar dokumentet në vijim:

- Aplikacionin për regjistrimin e vdekjes;
- Kopja e dokumentit të identifikimit, për personin që e raporton vdekjen;
- Dëshmia e dy dëshmitarëve, e verifikuar nga gjykata komunale;
- Kopja e certifikatës së martesës, nëse i ndjeri / e ndjera ka qenë i/e kurorëzuar. Nëse i ndjeri / e ndjera nuk ka qenë i/e kurorëzuar, ose ka qenë i/e pamartuar, ose ka qenë i/e shkurorëzuar, Zyra Komunale e Gjendjes Civile do ta bëjë këtë shënim në regjistra.

VËREJTJE ME RËNDËSI: Nëse vdekja ka ndodhur në shtëpi ose në ndonjë vend tjetër pa praninë e personelit mjekësor, personat që kanë qenë dëshmitarë të vdekjes duhet ta informojnë institucionin më të afërt shëndetësor për faktin e vdekjes dhe ta ftojnë ekipin mobil mjekësor, për ta vërtetuar atë fakt.

5. E DREJA PËR ANKESË

- Kërkesa e një personi për ta regjistruar një fakt të jetës në regjistra të gjendjes civile e inicon një procedurë administrative në nivel komunal.

- Kërkesës i bashkëngjiten dëshmitë e prezantuara nga parashtruesi i kërkesës. Administrata i shqyrton dëshmitë dhe vendos pozitivisht ose negativisht lidhur me kërkesën.

- Nëse vendimi është pozitiv, atëherë fakti i jetës evidentohet në Regjistrat e Gjendjes Civile. Nëse administrata e refuzon kërkesën, ajo e lëshon një vendim me shkrim, me të cilin i shpjegon arsyet e refuzimit.

- Pala e interesuar ka të drejtë ta kërkojë rishqyrtimin e vendimit administrativ dhe ta parashtojë një ankesë administrative kundër këtij vendimi.

- Ankesa administrative mund të jetë, qoftë:

- a. Një kërkesë për rishqyrtim të rastit nga ana e të njëjtit organ administrativ, ose
- b. Një kërkesë për parashtrim të ankesës në instancë më të lartë administrative.

- Afati i fundit për parashtrimin e një ankesë administrative është 30 ditë nga dita kur pala e interesuar ka marrë vendim negativ ose administrata, me vendim ka refuzuar shqyrtimin e kërkesës.

- Nëse administrata nuk e lëshon një vendim me shkrim për kërkesën e palës së interesuar (mos-lëshimi i aktit ose heshtja e plotë), afati i për parashtrimin e ankesës administrative është 60 ditë nga dita e dorëzimit të kërkesës në Komunë për regjistrim.

- Administrata duhet ta rishqyrtojë ankesën brenda 30 ditësh, nga iniciimi i procedurës së parashtrimit të ankesës.

- Të gjitha vendimet administrative duhet të jenë me shkrim dhe t'i shpjegojnë arsyet e refuzimit.

- Nëse palët e interesuara i kanë shteruar të gjitha mjetet administrative për apelim, ato mund t'i drejtohen gjykatës (Rishqyrtimi Gjyqësor).

ËSHTË ME RËNDËSI TË MBANI MEND:

- Regjistrojeni lindjen e fëmijës tuaj sa më shpejt që të mundeni. Preferohet që këtë ta bëni brenda 30 ditësh, nga data e lindjes, pavarësisht se a ka ndodhur lindja në spital ose në shtëpi.
- Drejtojuni Zyrës Komunale të Gjendjes Civile në komunën tuaj të banimit ose të lindjes. Zyrtarët do t'ju japin informata ose udhëzime përkitazi me hapat që duhet t'i ndërmerrni për ta regjistruar veten tuaj ose të tjerët.
- Nëse merrni ndonjë vendim negativ ose nuk merrni kurrfarë vendimi lidhur me gjendjen tuaj civile, ju lutemi ta keni parasysh që keni të drejtë ankese. Të gjitha vendimet administrative duhet të jenë me shkrim dhe t'i shpjegojnë arsyet e refuzimit.
- Nëse nuk posedoni kurrfarë dokumentesh, zyrtarët komunalë do t'ju informojnë për mënyrat alternative të prezantimit të dëshmive.

II. APLIKIMI PËR LETËRNJOFTIM DHE PASAPORTË

1. A KAM TË DREJTË TË APLIKOJ DHE KU MUND TË APLIKOJ?

Ju mund të aplikoni për dokument identifikimi nëse jeni më i vjetër se 16 vjeç. Aplikacionet dorëzohen në komunën ku ju banoni.

2. SI MUND TË APLIKOJ PËR DOKUMENT TË IDENTIFIKIMIT?

Ju mund t'i prezantoni në Zyrën e Regjistrimit Civil të Komunës së banimit tuaj këto dokumente:

- Certifikatën e lindjes;
- Certifikatën e shtetësisë (nëse e keni);
- Certifikatën e banimit;
- Kopjen e Letërnjoftimit të UNMIK-ut (nëse e keni)

Ju mund ta merrni dokumentin tuaj të identifikimit pa pagesë.

3. SI MUND TË APLIKOJ PËR PASAPORTË?

Pasi që ta keni marrë letërnjoftimin, ju mund ta parashtroni një aplikacion edhe për pasaportë. Në këtë rast, ju nuk keni nevojë të prezantoni dëshmi shtesë. Prindërit po ashtu mund të aplikojnë për pasaportë në emër të fëmijëve të tyre.

Për më shumë informata lidhur me këto çështje, ju lutemi t'i kontaktoni autoritetet e komunës në të cilën banoni.

Ju mund të merrni informacione shtesë në UNHCR ose në këto zyra të CRP/K-së:

CRP/K Prishtinë

Rr. "Bell Popova" # 10, Qyteza Peyton
Tel/fax: + 381 (0)38 243 610/611
E-mail: crp@crpkosovo.org

Zyra satelitore në Graçanicë

Ndërtesa e Mercy Corps

CRP/K Prizren

Rr. "Jeronim De Rada" # 63
Tel. + 381(0)29 222 552
E-mail: crp.pz@crpkosovo.org.com

CRP/K Pejë

Rr. "Nëna Terezë" # 31
Tel/fax: + 381 (0)39 432 669
E-mail: crp.pe@crpkosovo.org

Zyra satelitore në Gjakovë:

Rr. "Musa Zajmi" # 77,

CRP/K Mitrovicë

Rr. "Mbretëresha Teuta" # 03
Tel: +381 (0)28 539 458
E-mail: crp.mi@crpkosovo.org

Zyra satelitore në Zveçan:

Rr. "Kralj Petar Prvi", Ndërtesa e UNHCR-së

CRP/K Gjilan

Rr. "Lidhja e Prizrenit" # 32
Tel/fax: +381 (0)38 280 325 500
E-mail: crp.gl@crpkosovo.org